



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: + 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 68/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani-Kryetare, Agon Ramadani-Referuese dhe Vedat Poterqoi-Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik "NTP Gresa Commerce" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pelet, ri-tender" me numër të prokurimit "651-22-12392-1-2-1", iniciuar nga Komuna e Gjilanit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), me 20.04.2023, mori këtë:

VENDIM

1. Refuzohet si e pabazuar, ankesa e operatorit ekonomik "NTP Gresa Commerce" me seli në Prishtinë, e parashtruar në OSHP me 08.02.2023 (numër protokolli 68/2023) kurse mbetet në fuqi Vendimi i AK i datës 24.01.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit "Furnizim me pelet ri-tender" me nr. të prokurimit: "651-22-12392-1-2-1".
2. Konfiskohet shuma e mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore konform nenit 31 pika 5 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 08.11.2022, Komuna e Gjilanit në cilësinë e Autoriteti Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pelet ri-tender" me numër të prokurimit: "651-22-12392-1-2-1".

Me 24.01.2023, AK ka publikuar njoftim lidhur me Vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit, i përshkruar si më sipër.

Me 08.02.2023, OSHP (përmes sistemit elektronik) ka pranuar ankesë nga OE "NTP Gresa Commerce" (Protokolli 68/2023) e cila është ushtruar kundër vendimit të AK, të datës 24.01.2023.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 22.02.2023 ekspertët teknik/shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa të refuzohet si e pa bazuar;
- Të vërtetohet vendimi i AK për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Duke vepruar mbi bazën e parimeve të përgjithshme të parapara me nenet 6 dhe 7 dhe parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash janë sanksionuar në mënyre të veçantë me dispozitën e nenit 104, të Ligjit të cituar dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, konstatohet se:

- AK ka zbatuar procedurë të hapur të tenderimit, me kriteret si në vijim: lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës 106,750.00€
- Në këtë aktivitet të prokurimit kanë marr pjesë 4 grupe të operatorë ekonomik. Tenderi me çmim më të lartë përmbante vlerën 203,786.00 ndërsa tenderi me çmim më të ulët përmbante vlerën 178,980.00.
- Pretendimet kryesore mbi bazën e të cilave është ushtruar ankesa, janë drejtuar në atë se autoriteti kontraktues e kishte eliminuar pa të drejtë nga ky aktivitet i prokurimit.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Paneli Shqyrtues konsideroj se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrësat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor. Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar ka konstatuar se:

Pretendimi kryesor mbi bazën e të cilit ankuesi i është drejtuar OSHP, konsiston në atë se AK me vendimin e datës 21.11.2022 e kishte eliminuar pa të drejtë nga ky aktivitet, në kundërshtim me 7,59,60,72, të LPP. Me tej tutje pohon se AK edhe pas Rivlerësimit, sipas rekomandimit të OSHP, me vendimin e datës 24.01.2023 e kishte anuluar pa të drejtë këtë aktivitet të prokurimit dhe atë në kundërshtim me nenin 62 të LPP lidhur me nenin 43.5 dhe 43.7 i RRPR.

Lidhur me këtë Eksperti shqyrtues sqaron se AK me 21.11.2022, kishte kërkuar sqarime shtesë nga ankuesi, për kërkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional, cituar *”mjete të punës në dispozicion për realizimin e furnizimeve min. 1 kamion“* dhe tek dëshmia 2 dokumente valide për qarkullim dhe të lexueshme kopje, marrëveshje për huazim apo kontratë ose dud doganor” duke kërkuar që i njëjti deri me datën 23.11.2022 në ora 12.00 ti dorëzoj dëshmitë e kërkuara para hapjes së ofertave në përputhje me DT. Ankuesi pohon se nuk është përgjigjur dhe nuk i kishte ngarkuar në platformën e e-prokurimit dokumentet e kërkuara sipas kërkesës së AK, me arsyetimin se ka pasur probleme teknike me adresën elektronike.

Ankuesi ishte eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit me dt. 29.11.2022, mirëpo i njëjti nuk kishte parashtruar ankesë ne OSHP. Mirëpo një nga OE, pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimi kishte parashtruar ankesë ne OSHP, e cila ishte aprovuar me 10.01.2023 (Vendimi i OSHP Nr. 745/2022). Ankuesi mes tjerash pohuar se AK me rastin e rivlerësimit procesin duhet ta kthej në pikën zero dhe se para anulimit të aktivitetit, AK ka mundur të kërkoj sqarime sa i përket Librezës së Kamionit. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se AK me të drejtë në fazën e rivlerësimit nuk ka kërkuar përsëri sqarime ngase i njëjti ishte eliminuar më parë nga ky aktivitet dhe nuk kishë vepruar konform kërkesave për sqarime te AK, duke humbur kësaj statusin e palës së interesuar në kuptim të nenin 4. 1. 26 të LPP-së. Mbi bazën e të lartcekurave Eksperti Shqyrtues ka rekomanduar për panelin që të cilësohen si të pa bazuara këto pretendime dhe rrjedhimisht ka kërkuar që te vërtetohet vendimi i atakuar i AK për anulim.

-Konstatimet i panelit shqyrtues-

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore dhe administrimit të provave në tërësi, Paneli shqyrtues mbështet rekomandimet e ekspertit për shkaqet dhe arsyet si në vijim:

Në kuptim të LPP, apriori çdo AK gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitetet buxhetore. Po ashtu, është fakt notor se në vështrim të legjislacionit, ndryshimi rrënjësor i kushteve dhe/ose rrethanave të cilat ndikojnë qenësisht në efektin e raporteve kontraktuese, i jep të drejtë një pale që ta rishikoj vullnetin, gatishmërinë dhe statusin e sajë kontraktues dhe/ose ta revokoj vendimin, nëse përmbushja e detyrimeve nuk është e mundur dhe/ose atakon aftësitë paguese dhe burimet financiare, të domosdoshme për ushtrimin e kompetencave primare.

Prandaj Paneli konsideron se anulimi i vendimit të atakuar dhe kthimi i këtij aktiviteti të prokurimit në rivlerësim, bie ndesh me parimet dhe dispozitat e prokurimit publik sepse AK vendoset pa të drejtë në një gjendje ku objektivisht do ta kishte të pamundur nënshkrimin e kontratës pa i siguruar paraprakisht mjetet në përputhje me nenin 8.3 të RRUOPP, sipas të cilit “Nëse AK është autoritet publik ose organizatë buxhetore ZKF do të siguroj që: a. Fondet janë alokuar; ose b. Fonde të mjaftueshme do të alokohen në vitin fiskal në fjalë” Aq më tepër, thuhet se “Kjo dispozitë do të përfshihet në kontratën publike”.

Paneli shqyrtues detyrohet ta marrë në konsideratë faktin parimor se, tenderi i ofruar nga OE ankues sipas shumës së ofruar në procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, ka tejkaluar buxhetin e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit dhe është njoftuar zyrtarisht nga AK me anë të letrës standarde për tenderuesin e eliminuar dhe me anë të pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e tij e atakon vendimin e AK për anulimin e aktivitetit të prokurimit por nuk e argumenton pohimin se a është i përgjegjshëm apo jo, andaj i njëjti nuk ka interesin juridik në këtë procedurë të prokurimit të paraparë sipas nenit 4. 1. 26 të LPP-së.


Paneli Shqyrtues i ka analizuar shkresat e kësaj lënde, pretendimet ankimore, veprimet e AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe me këtë rast duke ju referuar parimeve bazë të procedurave të prokurimit publik, ka konstatuar se raporti i ekspertit shqyrtues përmban një vlerësim profesional dhe të argumentuar të pohimeve të ankuesit dhe gjitha fakteve dhe rrethanave tjera të analizuar si më sipër prandaj rekomandimet e dhëna janë miratuar edhe nga Paneli Shqyrtues i OSHP.

-Përfundim -

Paneli Shqyrtues vlerëson se aktiviteti i prokurimit është anuluar në harmoni me nenin 62, paragrafi 2, të LPP, lidhur me nenin 43 pika 7, të Rregullores 001/2022, me ç'rast procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet nëse të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK. Pavarësisht kësaj, ankuesi nuk ka qenë i përgjegjshëm në këtë procedurë të prokurimit dhe nuk ka ofruar informacionet e nevojshme edhe pas kërkesës për sqarim, prandaj Paneli vlerëson se AK ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP dhe ka vepruar ashtu siç edhe parashihet në nenin 7 të LPP.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, kurse Vendimi sikurse në pikën 2, të dispozitivit është marrë ne kuptim të nenit 31, paragrafi 1, i Rregullores se punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues
Vjosa Gradinaj Mexhuani



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

- 1x1 AK KK Gjilan
- 1x1 (GOE) "Gresa Commerce"
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.